



AKT THEMELIMI PËR KRIJIMIN E SHOQERISE B A I TEL SH. P. K

Sot ne daten15/5/2002 nga ortaku i vetem BOJO BRAHIM BEGOTARAJ krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar B.A.I TEL SH.P.K sipas kushteve te meposhtme.

NENI 1

Personat fizik i siperpermendur me vullnetin e tij te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar vendosi qe te krijojte shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin B.A.I TEL SH.P.K. me kapital themeltar 100.000 leke.
Kjo shoqeri e ka seline ne adresen: Radhime Vlore

Administrator i shoqerise do te jete: BOJO BRAHIM BEGOTARAJ

Shoqeria B.A.I TEL SH.P.K. ka te drejte te krroje filialet e saj dhe te marre pjese ne shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe do te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente kur eshte e nevojshme

NENI 2

Shoqeria B.A.I TEL SH.P.K. gezon statusin e personit juridik.
Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit (te dyja se bashku te quajtura Aktet e themelimit) dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese integrale e saj.


NENI 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin dhe licensat e marra nga organet perkatese te gjyqesorit dhe administrativit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohore rmbi 10 vjet.
Shoqeria mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate neqoftese ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjasin kete afat.
Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni ne se per kete marrin vendim unanim te gjithe ortaket qe bejne pjese ne kete shoqeri.

NENI 4

Shoqëria B.A.I TEL SH.P.K. do ta ketë objektin e aktivitetit të saj në fushën e:

- Eksport-importit,
- Bar – Restorant Hoteleri
- Telekomunikacionit.
- Shitje-blerje dhe dheme me qera



NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë B.A.I TEL SH.P.K. përbehet nga të holla që kapin vlerën 100.000. leke

Kapitali i mesipërm është kontribuar nga ortakët i vetëm dhe *zotërohet* teresisht prej tij. Kapitali i shoqërisë është depozituar në llogarinë e shoqërisë pranë një Banke.

NENI 6

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie do të ndahet midis ortakëve në përputhje me kontributin e tyre respektiv, në kapitalin e Shoqërisë

NENI 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, shoqëria B.A.I TEL SH.P.K. përgjigjet vetëm me kapitalin e saj dhe jo me pasurinë individuale të ortakëve.

NENI 8

Nuk mund të pranohet si ortak në këtë shoqëri një person i tretë, pa patur pelqimin e tre të katertave të ortakëve të tjerë. Si rregull i përgjithshëm ortakët nuk mund të transferojë lirisht pjesën e tij të kapitalit pa marrë me përpara pelqimin e ortakëve të tjerë. Ai është i detyruar që para se transferojë pjesën e tij të kapitalit, ta ofrojë atë ortakëve të tjerë. Vetëm në rastet kur ortakët e tjerë nuk e pranojnë blerjen ose nuk japin përgjigje brenda 90 ditëve nga data e bërjes së ofertës atëherë ortakët janë të lirë të transferojë lirisht pjesën e tij.

NENI 9

Ortakët janë të detyruar të ruajnë karakterin konfidencial të aktivitetit të shoqërisë. Ortakët që shkel detyrimin e mesipërm dhe nga kjo shkelje, shoqërisë ose ortakët tjerë i shkaktohet një dëm, ai është i detyruar të shpërblejë dëmin.

NENI 10

Marredheniet e punës që do të lindin midis shoqërisë dhe personave të punësuar prej saj do të rregullohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konfliktet që lindin ndërmjet ortakëve do të zgjidhen në marreveshje ndërmjet tyre. Në të kundërt kompetentë për zgjidhjen e tyre do të jete Gjykata e rrethit të Tiranës dhe ligji i zbatueshëm do të jete ai shqiptar.

Nga:

Titulli: ADMINISTRATOR DHE ORTAK I VETEM

Bojo BEGOTARAJ

Bojo Begotaraj

STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

B.A.I TEL SHPK

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar themelohet ne perputhje me Ligjin 7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite Tregetare" me emrin B.A.I TEL SH.P.K. me seli ne Vlore
Kjo shoqeri krijohet nga ortaku i vetem:

BOJO BRAHIM BEGOTARAJ

Shoqeria ka seline e saj ne Vlore ne adresen RADHIME VLORE . Shoqeria B.A.I TEL SH.P.K. ka te drejte te cele filiale e perfaqesi dhe te marre pjese ne shoqeri te tjera ne Shqiperi e jashte saj ne perputhje me legjistacionin perkates shqiptar dhe ate te vendit respektiv jashte territorit te Shqiperise.

ADMINISTRATOR i shoqerise eshte:

BOJO BRAHIM BEGOTARAJ

NENI 2

Shoqeria B.A.I TEL SH. P.K. zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjistacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (Akti I Themelimit dhe Statuti).

Shoqeria B.A.I TEL SH.P.K. eshte person juridik. Ajo fiton personalitetin juridik ne ditën e regjistrimit te saj ne Gjykate.

NENI 3

Shoqeria B.A.I TEL SH.P.K. do ta ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe mbi 10 vjet.

Megjithate kjo Shoqeri mund te zgjase afatin e veprimtarise se vet ose mund te mbylle aktivitetin e saj perpara ketij afati ne perputhje me dispozitat e dokumentave te krijimit te saj dhe kriterëve perkatese te legjislacionit ne fuqi



NENI 4

Shoqeria B.A.I TEL SH.P.K. per detyrimet qe linden gjate aktivitetit te saj me te tretet pergjigjet vetem me pasurine e saj.


Ortaket e kesaj shoqerie nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj Shoqerie me pasurine e tyre personale qe nuk eshte pjese e kapitalit te kesaj Shoqerie. Pjesemarrja ne kete shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie jashte kesaj Shoqerie.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE B.A.I TEL SH.P.K.

NENI 5

Objekti i Shoqerise B.A.I TEL SH.P.K. do te jete ne fushen e:

- Eksport-importit;
- Bar restorant Hoteleri
-
- Telekomunikacion.
- Shitje- blerje ,dhenie me qira ambientesh ,etj





KREU II

MARREDHENIET EKONOMIKE – FINANCIARE

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise B.A.I TEL SHP.K. perbehet nga te holla qe kapin vleren 100.000. leke

Kapitali i mesiperm qe eshte i paguar plotesisht, dhe zoterohet teresisht nga ortaku i vetem.

NENI 7

Kapitali ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme si ndermjet ortakeve ashtu edhe ndermjet personave te trete.

Transferimi i kapitalit ose i pjeseve te caktuara te tij ndermjet ortakeve eshte i lire. Transferimi ne favor te personave te trete behet gjithmone me vendimin e ortakeve qe perfaqesojne tre te katertat e kapitalit. Ne te dyja rastet transferimi behet me akte noteriale.

Ne qofte se njeri nga ortaket deshiron te transferoje pjesen e kapitalit te tij duhet te respektojte te drejten e parablerjes nga ortaku ose ortaket e tjere. Vleresimi i kontributeve te kapitalit ne natyre behet nga ortaket duke caktuar nje ekspert ose ne pamundesi te kesaj marreveshje nga nje ekspert i caktuar nga gjykata sipas kerkeses se ortrakut.

NENI 8

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit per nje, disa ose te gjitha ortaket behet me vendimin e ortakeve qe perfaqesojne tre te katertat e kapitalit. Ne cdo rast zmadhimi ose zvogelimi te tij te gjitha ortaket preken ne te njejten mase proporcionale me pjesen e kapitalit qe ata zoterojne.

NENI 9

Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjese e tyre takuese ne kapitalin e shoqerise.



BILANCI DHE VITI FISKAL

NENI 10

Vepriintaria e shoqerise zhvillohet mbi bazen e leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

Viti fiskal i shoqerise fillon ne daten 1 Janar dhe perfundon ne date 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.

Bilanci i aktivitetit ekonomik te shoqerise duhet te perpilohet jo me vone se 31 Marsi pasues i vitit fiskal.

Shqyrtimi i bilancit dhe rezultave te tij si dhe aprovimi perfundimtar i tij duhet te behen jo me vone se 30 Qershori pasues i vitit fiskal.

FONDET E TJERA TE SHOQERISE

NENI 12

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj ne perputhje me legjistacioni ne ttiqi.

Krijimi i fondeve dhe burimet e tyre financiare caktohen nga Asambleja e Ortakeve

KREU III

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

NENI 13

ORTAKET kane te drejta te cilat ushtrohen ne perputhje me ligjin dhe aktet e themelimit

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise ne perputhje me aktet e themelimit;
- Te kerkoje dhe te marre te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimtarine e shoqerise si dhe te marre cdo dokument te perpiluar nga shoqeria (bilanci, libra llogarie etj),
- Te beje propozime me shkrim dhe t'i paraqese ato para Asamblese se Ortakeve dhe organeve te tjera te shoqerise,
- Te drejta te tjera qe u njihen nga ligji dhe aktetet e themelimit



NENI 14

ORTAKET kane ndermjet te tjerave keto detyrime kryesore:

- Te paguajne kuoten e plote te tyre dhe kuotata e tjera suplementare ne perputhje me aktet e themelimit dhe vendimet e tjera te shoqerise;
- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuar ne baze te akteve te themelimit,
- Te kryejne detyrimet e ngarkuara nga organet e shoqerise per realizimin e ohjektivave te shoqerise.

KREU 1V

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 15

Organi me i Larte vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve Ne Asamble marrin pjese te gjithë ortaket, fuqia votuese e te cileve eshte ne perputhje me kontributin e tyre ne kapitalin e shoqerise.

Asambleja e Ortakeve ndermjet te tjerave vendos per keto probleme

- Miraton bilancin vjetor te shoqerise.
- Vendos per shtimin, pakesimin ose transferimin e kapitalit te shoqerise.
- Vendos per mbylljen ose likuidimin e aktivitetit te shoqerise dhe per shnderrimin e saj ne nje lloj tjeter shoqerie.
- Vendos per ndryshimet ne statut dhe ne aktin e themelimit.
- Vendos per çdo çeshtje tjeter qe u paraqitet atvire nga organet e tjera te shoqerise

NENI 16

QUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Ortakeve thirret jo me pak se nje here ne vit.


Lajmerimi behet 15 dite para dates se mbledhjes nga administratori dhe ne mungese te tij nga eksperti kontabel. Ne letren e lajmerimit percaktohet edhe rendi i dites.

Gjithashtu, çdo ortak qe perfaqeson te pakten 10% te kapitalit te shoqense ka te drejte te kerkoje thirrjen e Asamblese.

Me perjashtim te rasteve kur ne kete Statut parashikohet ndryshe, qe mbledhjet e Asamblese te jene te vlefshme, ne te duhet te marrin pjese ortaket qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kapitalit te shoqerise.

Ne te tilla raste, vendimet merren me shumicen e votave te ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit. Ne rastet e tjera perjashtimore, vendimet merren me shumicen e kerkuar sipas percaktimeve te bera ne dispozita te vecanta te ketij Statuti.

Ne rast se kjo perfaqesi nuk sigurohet atehere ne mbledhjen e dyte vendimi merret me shumicen e votave te dhena, pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe ato zoterojne.



NENI 17

ADMINISTRIMI

Administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marredheniet me personat e trete. Ne rastin e dy administratoreve secili dhe pavaresisht nga njeri-tjetri kane kompetence te administrojne shoqerine brenda kompetencave te dhena.

Administratori i shoqerise nuk mund te kryeje vetem ato transaksione qe jane rezervuar per Asanblene e Ortakeve.

Shoqeria merr peresiper te gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e Administratorit edhe kur ato nuk perfshihen ne objektin e shoqerise. Ne nje rast te tille shoqeria mund te mos jete pergjegjese vetem ne rast se ajo provon qe te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose rrethanat e dhena nuk mund ti lejonin te tretet qe ta injoronin kete fakt.

NENI 18

Administratori pergjigjet individualisht ndaj Shoqerise ose ndaj personave te trete, kur gjate aktivitetit te tij shkel ligjin, aktete e themelimit apo kontratat e tjera ose per veprime te tjera me faj gjate administrimit te Shoqerise.

Emerimi dhe shkarkimi i tij behet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e kapitalit. Ne te njeten menyre vendoset edhe per kompensimin ne te holla per detyren qe kryen Administratori i shoqerise.

KREUV

EKSPERTI KONTABEL


NENI 19

Per kontrollin e veprimtarise se shoqerise, ne rast se do te jete e nvojshme dhe e kerkueshme ligjerisht, do te caktohet nje ekspert kontabel. Ai emerohet nga Asambleja e Ortakeve e cila cakton edhe masen e kompensimit te tij.

Detyrat kryesore te ekspertit kontabel, qe kryhen pa nderhyre ne administrimin e shoqerise jane:

- Te garantojne qe llogarite vjetore jane te rregullta e te hartuara me sinqeritet dhe japin nje pasqyrim besnik te rezultatit te operacioneve te vitit perkates financiar si dhe te gjendjes financiare te trashegimise se shoqerise ne fund te vitit respektiv financiar.

- Ne menyre te perhershme te verifikojte librat e llogarise dhe fondet e shoqerise, si dhe te kontrolloje pershtatjen e kontabilitetit te saj me legjislacionin ne fuqi.
- Verifikojne sinqeritetin dhe perputhjen me llogarite vjetore te informacioneve te dhena ne raportin e administrimit nga ana e administratoreve dhe ne dokumentat e tjera qe u jane derguar ortakeve mbi gjendjen financiare dhe llogarite vjetore.



KREUVI

DISPOZITA TE PERZIERA

NENI 20

Ne rastet kur ky Statut eshte i heshtur per ceshtje te cilat linden gjate ekzistences se Shoqerise, te zbatueshme do te jene dispozitat e Ligjit 7638 date 19/1 1/1992 Per shoqerite Tregetare dhe ligjet dhe aktet e tjera te lidhura me te.

Per cdo mosmarreveshje qe do te linden midis ortakeve, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Vlores, dhe ligji i zbatueshern do te jete ai shqiptar

Nga:

Titulli: ORTAK I VETEM DHE ADMINISTRATOR

Bojo BEGOTARAJ

Bojo Begotaraj
Ber.